

open. analizë

casa >>




Qytetarët në politikë

Pluralizmi politik në komunitetin serb në Kosovë

prill
2022







Titulli i hulumtimit: Qytetarët në politikë – Pluralizmi politik në komunitetin serb në Kosovë

Botuesi: KFOS

Për botuesin: Qendra për Veprime Sociale Afirmative (Centar za Afirmativne Društvene Akcije) – CASA

Qendra Humane Mitrovicë
(Humani Centar Mitrovica)

Autorët: Miodrag Marinković – CASA

Srdjan Simonović – HMC

Veroljub Petronić – HMC

Redaktimi: Aleksandar Rapajić

Lekturimi: Milena Redžić-Simić

Maksim Aksić

Driton Sefedini

Përkthimi: Nora Bezera

Ines Aljović Mihajlović

Dizajni:

Innovation Media

Tirazhi: 80 copë

Ky publikim u realizua në kuadër të projektit OPEN të cilin e zbaton Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat CASA dhe HCM. Qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin ekskluzivisht autorëve të hulumtimit dhe nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

Viti i publikimit: prill, 2022

Përmbajtja

7 Rreth Nismës OPEN

Rreth qëllimeve të hulumtimit të Nismës OPEN

8 Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kuantitativ (hulumtimi sasior)

9 Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kualitativ (hulumtimi cilësor)

9 Konteksti shoqëroro-politik

13 Rezultatet e hulumtimit

13 Struktura e hulumtimit

11 Rezultatet: Sjellja e përgjithshme politike

20 Rezultatet: Praktikat mbizotëruese të marrjes me politikë

23 Perceptimet e pozitës së privilegjuar të aktivistëve politikë

32 Fokusi i veçantë: Marrëdhënia e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) me politikanë

37 Përfundimet

39 Rekomandimet



INFORMATAT THEMELORE RRETH HULUMTIMIT

Rreth nismës OPEN

Hulumtimi është realizuar në kuadër të nismës OPEN. "Demokracia, çiltëria dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë – OPEN" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) që është nisur në vitin 2020. OPEN realizohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile të cilat veprojnë në komunitetin serb në Kosovë. Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është zhvillimi i hapësirës së çiltër dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, mes komunitetit serb dhe komuniteteve tjera si dhe institucioneve në Kosovë.

Fokusi i nismës do të jenë analiza dhe vlerësimi i ndikimit të organizatave civile dhe politike në demokratizëm dhe çiltëri të komunitetit serb në Kosovë. Do të analizohet dhe do të vlerësohet demokratizmi dhe çiltëria e institucioneve, të politikave publike dhe proceseve të rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e çiltërisë së komunitetit serb ndaj të njëjtave. Këto analiza do të ndihmojnë që të shihen gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, derisa në të njëjtën kohë do të shërbejnë si bazë për përfaqësim të argumentuar para qytetarëve, institucioneve të pushtetit lokal dhe qendror, sikur dhe para komunitetit ndërkombëtar. Anëtarët e platformës OPEN janë organizatat e shoqërisë civile me përvojë dhe të dëshmuara, të cilat do të bashkëpunojnë për arritjen e qëllimeve të përgjithshme dhe specifike të platformës. Kjo i përfshinë edhe organizatat bartëse të këtij

hulumtimi - Qendrën për Veprime Sociale Afirmative dhe Qendrën Humanë Mitrovicë.

Rreth qëllimeve të hulumtimit të nismës OPEN

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është analiza e praktikave ekzistuese dhe modaliteteve të aktivizmit politik brenda komunitetit serb në Kosovë. Në kontekstin e hulumtimit, nocioni aktivizmi politik është interpretuar si proces i mbrojtjes së interesave të qytetarëve përmes angazhimit në parti politike ose përmes proceseve politike (për shembull fushatat aktive zgjedhore, nismat qytetare etj.). Prandaj, në thelb si çdo proces i cili çon deri te ndërveprimi mes qytetarëve dhe pushtetit lokal dhe/ose qendror me qëllim të avancimit të praktikave dhe ligjeve ekzistuese ose të pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes. I përkufizuar në këtë mënyrë, aktivizmi politik paraqet një nocion jashtëzakonisht të gjerë, sepse pothuajse çdo angazhim shoqëror i qytetarëve të atij lloji në thelb ka karakter politik ose çon deri te ndërveprimi me përfaqësues politikë. Për këtë arsye autorët e raportit u përpoqën t'i shohin në një kontest më të gjerë duke i analizuar modalitetet e angazhimit qytetar, duke e përfshirë sektorin civil, aktivizmin lokal qytetar dhe të ngjashme.

Tematikusht hulumtimi i sheh tre (3) aspekte të këtij procesi. Pjesa e parë merret me perceptimet e qytetarëve (të komunitetit serb në Kosovë) për veprimtarinë politike

(profesionale ose përmes aktivizimit qytetar). Fokusi i kësaj pjese të hulumtimit ishte vërtetimi i pengesave dhe mundësive për përfshirje më aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal dhe atë qendror. Aspekti tjetër i hulumtimit i ka analizuar praktikën mbizotëruese të përfaqësuesve politikë të komunitetit serb ndaj përfshirjes (dhe konsultimit) të qytetarëve në marrjen e vendimeve që janë të rëndësishme për jetën e tyre. Në pjesën e fundit hulumtimi e analizon një dinamikë të veçantë të marrëdhënies së qytetarëve me përfaqësuesit e tyre politikë, duke u fokusuar në modelet e bashkëpunimit të organizatave të shoqërisë civile me politikanë dhe përfaqësues të pushtetit.

Metodologjikisht, studimi i kombinon elementet e hulumtimit kuantitativ (sondazhet dhe përpunimi statistikor) dhe të hulumtimit kualitativ (fokus grupet dhe intervistat) sociologjik. Janë përdorur referencat nga cikli i vitit të kaluar të hulumtimit OPEN dhe të raportit të konsoliduar si dhe gjetjet nga hulumtimet e tjera relevante dhe nga raportet e mediave të grumbulluara përmes hulumtimit sekondar (i ashtuquajtur “desk research”).

Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kuantitativ (sasior)

Hulumtimi në terren përmes sondazhit ballë për ballë është zbatuar gjatë periudhës tetor-nëntor të vitit 2021. Në tërë territorin e Kosovës, gjithsej janë marrë në pyetje 500 qytetarë të kombësisë serbe. Pyetësi përbëhej nga 46 pyetje dhe i përpunonte gjithsej 6 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, kuotë, kurse kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës së banimit. Intervali i besimit është +/-5. Shpërndarja sipas vendbanimit është si në vijim:

Në mostër ishin gjithsej 60% të meshkujve dhe 39.8% të grave. Mosha mesatare e të anketuarve është 42 vjet. 5, 4% të të anketuarve që janë marrë në pyetje e kanë përfunduar shkollën fillore, shkollën e mesme e kanë përfunduar 47% dhe shkollën e lartë, përkatësisht fakultetin e kanë përfunduar 45% të të anketuarve. Nga numri total i të anketuarve, 58% janë të punësuar, kurse 42% prej tyre nuk punojnë ose janë në pension.

Është e rëndësishme të ceket që duke e marrë parasysh faktin që nuk ekzistojnë të dhënat zyrtare statistikore për strukturën demografike e popullsisë së synuar, përkatësisht të popullatës serbe në Kosovë, vetëm me kusht mund të flasim për përfaqësimin e mostrës.

Komuna:	V	%	% e vlefshme:	% kumulative:
e vlefshme: Leposaviaq	110	22.0	22.0	22.0
Kamenicë	10	2.0	2.0	24.0
Novobërdë	30	6.0	6.0	30.0
Zubin Potok	50	10.0	10.0	40.0
Shtërpcë	30	6.0	6.0	46.0
Zveçan	60	12.0	12.0	58.0
Graçanicë	60	12.0	12.0	70.0
Ranillug	30	6.0	6.0	76.0
Partesh	10	2.0	2.0	78.0
Kllokot	10	2.0	2.0	80.0
Mitrovica e Veriut	100	20.0	20.0	100.0
Total:	500	100.0	100.0	

Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kualitativ

Fokus grupet

Koha:

Hulumtimi është zbatuar nga nëntori i vitit 2021 deri në janar të vitit 2022.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzuesi për bisedim i përbërë nga 7 njësi (pjesë) tematike.

Numri i fokus grupeve:

4 (2 në veri e 2 në jug të lbrit)

Numri total i pjesëmarrësve: 40 pjesëmarrës

Kriteri për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

variabla siç janë gjinia, mosha, vendbanimi, niveli i arsimit.

50% e më shumë ose arsimim i lartë,

50% - nën arsimim të lartë

30% të popullsisë rurale dhe

70% të popullsisë urbane

50/50 raporti i gjinisë femërore dhe

mashkullore të pjesëmarrësve

mosha 18+ (madhore)

Intervistat

Koha:

Hulumtimi është zbatuar nga nëntori i vitit 2021 deri në janar të vitit 2022.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzuesi për bisedim i përbërë nga 4 fusha (20 pyetje).

Numri total i të intervistuarve:

10 të intervistuar

Kriteri për përzgjedhje të bashkëbiseduesve:

pjesëmarrja në jetën shoqërore dhe politike të komunitetit serb në Kosovë

Bashkëbiseduesit:**Darko Dimitrijević**

kryeredaktor i Radio Gorazhdecit,

Aleksandrar Rapajić

drejtor i programit në OJQ-në ACDC,

Goran Avramović

kryeredaktor i RTV KiM-it,

pjesëmarrësit e tjerë kanë kërkuar të jenë anonimë.

Konteksti shoqëro-ro-politik

Rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikë është aksiomë e praktikës demokratike. Teoria, por edhe praktika e shoqërisë demokratike tregojnë që nuk mjafton që një shoqëri t'i ketë institucionet e themeluara me procese demokratike, por është e domosdoshme që ato institucione ta përmbushin qëllimin e tyre themelor, e ai është që t'ua sigurojnë qytetarëve, të cilët i kanë zgjedhur, një jetë dinjitoze, të sigurt dhe produktive. Një gjë e tillë është e mundur vetëm nëse institucionet i kryejnë obligimet e veta me përgjegjësi. Thelbi i karakterit demokratik të qeverisë qëndron pikërisht në termin ushtrim i përgjegjshëm i pushtetit. Pra, ky është në thelb “një proces rrjedhës dhe i vazhdueshëm i udhëhequr nga parimet e legjislacionit, çiltërisë dhe praktikave të mira, në të cilin pushtetet punojnë në mënyrë aktive për të përmirësuar përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, kurse qytetarët janë të lirë dhe të inkurajuar për të marrë

pjesë në proceset politike.

Megjithatë, në praktikë, tiparet e tilla i kanë plotësisht vetëm demokracitë shumë të zhvilluara, në radhë të parë të ashtuquajturat “demokracitë nordike”¹ (Suedia, Norvegjia, Finlanda, Islanda, Danimarka) dhe disa vende perëndimore me një traditë të gjatë të organizmit² demokratik si Irlanda, Kanada, Australia etj. Në vendet e tjera të cilat kualifikohen si demokratike, në një masë më të madhe ose më të vogël ekziston një tendencë gjithmonë e pranishme e pushteteve për të rezervuar sa më shumë autoritet për vete. Kjo gjë është veçanërisht e theksuar në shoqëritë në tranzicion të Evropës Lindore dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Më shumë se tri dekada pas fillimit të proceseve të demokratizimit, në një numër të tyre vendeve u krijua një “fasadë demokratike”³ përmes promovimit të kornizës legjislative e cila normativisht e garanton lirinë e shprehjes, sundimin e ligjit, gjyqësorin e pavarur dhe kështu me radhë, por në realitet elitat politike ende mbështeten në strukturat joformale, klientelizëm dhe kontrollin e mediave⁴.

Në këtë kuptim Kosova nuk dallohet nga shoqëritë e tjera, përkundër disa veçorive. E njëjta gjë vlen edhe për komunitetin serb në Kosovë, brenda të cilit ka disa specifika të caktuara në pikëpamje të raportit të qytetarëve ndaj pjesëmarrjes në procesin politik. Para së gjithash, është një kuptim mbizotërues i politikës dhe i natyrës së angazhimit politik përmes konfliktit etnik me shqiptarët⁵. Rrallë kur në historinë e

1 “Nordisk Demokrati” – termi të cilin për herë të parë e kanë përdorur Hal Koch dhe Alf Ross, Copenhagen, 1949, në publikimin e përbashkët të Institutit Danez, Zyrës Norvegjeze për Marrëdhënie Kulturore dhe Institutit Kombëtar të Suedisë. <https://www.foreignaffairs.com/reviews/capsule-review/1959-07-01/scandinavian-democracy>

2 Dhe pa historinë e kolonializmit- Ibid, 33

3 Marko Kmeziq (Marko Kmezić)- Sundimi i ligjit dhe demokracia në Ballkanin Perëndimor – rreth mospërputhjes mes politikave dhe praktikave, faqja 3, abstrakti, janar i vitit 2020 - [linku](#)

4 Ibid – faqja 3

5 Më shumë për tezë – Serbët e Kosovës në të dy anët e lumit – Ndarje për të cilat heshtet - <https://www.radiokim.net/vesti/analiza/kosovski-srbi-sa->

marrëdhënieve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë pati mjaft stabilitet dhe bashkëpunim në mënyrë që angazhimi politik i përfaqësuesve të tyre të fokusohet në çështjet ekzistenciale të qytetarëve, çështjet e ekonomisë, të cilësisë së arsimit, në drejtësinë sociale⁶. Në vend të kësaj, angazhimi politik, në masë më të madhe, u përkufizua me qëndrime ndaj konfliktit etnik. Karakteri i tillë i veprimit politik të serbëve të Kosovës pashmangshëm u zhvillua nën presionin e rivalitetit etnik me shqiptarët dhe imperativit të veprimit të harmonizuar me Beogradin, gjegjësisht të krijimit të një platforme unike politike të serbëve të Kosovës. Qëllimi i fundit, siç u tregua pas konfliktit të vitit 1999, u bë i paarritshëm kur komuniteti serb në Kosovë e gjeti veten të ndarë në dy realitete politiko-shoqërore - njëri në veri të Kosovës ku jeton një komunitet homogjen serb me lidhje të forta gjeografike, ekonomike dhe politike me Serbi dhe tjetri në komunitetin heterogjen serb në jug të lumit Ibër, i cili është nën presion më të madh të integritetit. Pavarësisht dallimeve të tilla objektive të cilat i kanë krijuar dy realitete, presioni ndaj serbëve në jug të lumit Ibër për të ndjekur politikën të cilën e kanë përfaqësuar zyrtarisht Beogradi dhe liderët politikë të serbëve nga veriu i Kosovës nuk ka pushuar kurrë, kurse çdo angazhim politik përtej kësaj kornize është pritur me gjykime publike dhe akuza për tradhti ndaj interesave kombëtare. Kështu për shembull, disa iniciativa politike dhe liderët e tyre që merrnin pjesë në zgjedhjet e Kosovës⁷ përtej rekomandimeve të Beogradit (jashtë rekomandimeve të Beogradit) u shpallëshin tradhtarë kombëtarë që punojnë jashtë interesave të komunitetit serb⁸, edhe pse shumë shpejt pastaj (më pak se 4 vjet), pjesëmarrja e tillë është bërë politikë zyrtare shtetërore e Republikës së Serbisë.

Këtu vijmë te një veçori tjetër. Domethënë, është pikërisht interesi i serbëve dhe i Serbisë

[obe-strane-reke-podele-o-kojima-se-cuti.html](https://www.slobodnaevropa.org/a/28191101.html)

6 Ibid

7 Zgjedhjet e organizuara në kuadër të rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës – prim.aut

8 Evropa e Lirë: Stojanović: Tradhtia e veprës së deputetëve serbë - <https://www.slobodnaevropa.org/a/28191101.html>

në Kosovë, i cili shumë shpesh imponohet si kornizë e veprimit të lejuar politik të serbëve të Kosovës, që kurrë nuk është përkufizuar në mënyrë strategjike.



Në vend të kësaj, interesi kombëtar barazohet me interesat e ngushta partiake të partive në pushtet në Beograd, të cilat interpretohen në mënyrë agresive si shtetërore, kurse secila parti e re në pushtet në Serbi e instalon nomenklaturën e saj politike në Kosovë, nga e cila pritet të ndjekë verbërisht udhëzimet e partisë dhe politikën?

Një raport i tillë uniform i Serbisë dhe elitave të saj politike ndaj serbëve të Kosovës, si dhe lidhja e saj thelbësore institucionale me Beogradin, pashmangshmërisht rezultojnë me ekskluzivitet ideologjik dhe organizativ në përfaqësimin politik të serbëve të Kosovës. Pikërisht për këtë gjë tregojnë rezultatet e hulumtimit të vitit të kaluar OPEN 2020. Përfundimet kryesore të këtij hulumtimi¹⁰ tregojnë se në komunitetin serb në Kosovë është vendosur monopoli në përfaqësimin politik nga një opion politik - Listës Serbe, e cila e gëzon mbështetjen e plotë dhe ekskluzive të Beogradit zyrtar. Me mbështetjen e pushtetit në Beograd, ata po ushtrojnë presion të fuqishëm mbi kundërshtarët politikë dhe votuesit e tyre brenda komunitetit serb në Kosovë, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, madje edhe metodat të cilat

9 Autori i njëjtë – Serbët e Kosovës në të dy anët e lumit – Radio KiM <https://www.radiokim.net/vesti/analiza/kosovs-ki-srbi-sa-obe-strane-reke-podele-o-kojima-se-cuti.html>

10 <https://kfos.org/en/publications/110/karakteris-tike-otvorenog-drustva-u-srpskoj-zajednici-na-kosovu>, faqja 121, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

nuk kanë karakter demokratik. Për shembull diskreditimi agresiv mediatik (fushatat e njollosjes) i kundërshtarëve apo kritikëve të pushtetit, diskriminimi në qasje në burime (duke e përfshirë procesin zgjedhor), madje edhe presioni i natyrës ekzistenciale, si për shembull nepotizmi partiak në qasje në punë në sektorin publik. Autorët e hulumtimit përfundojnë se “përmasat dhe sistematika e përpjekjeve të tilla (...) janë të pranishme në atë masë në të cilën mund të konkludohet se pluralizmi politik brenda komunitetit serb në Kosovë është ngulfatur sistematikisht¹¹.” Edhe pse manifestimet e një marrëdhënieje të tillë janë bërë më të dukshme me paraqitjen e Listës Serbe dhe ardhjen e Partisë Përparimtare Serbe në pushtet në Serbi¹², një marrëdhënie e tillë në një formë të shprehur më pak, a më shumë, dekada më parë ishte një modus operandi në raportin e Beogradit ndaj serbëve të Kosovës.

Pasojat e një marrëdhënieje të tillë janë të shumfishta. Para së gjithash, liria për të përfaqësuar interesat e komunitetit serb në Kosovë përmes dialogut të hapur social, në llojllojshmërinë e tij, madje edhe nëse ato dallojnë nga qëndrimi zyrtar i Beogradit, jo vetëm që nuk ekziston, por një akt i tillë bartë me vete rreziqe të caktuara për individë apo grupime politike. Pastaj është frika pothuajse e prekshme e qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë nga përfaqësuesit e tyre politikë, të cilët në mënyrë agresive e njëjsojnë çdo kritikë ndaj punës së tyre me tradhtinë e interesave kombëtare. Në fund këtu është edhe disfatizmi konsekuent, përkatësisht mungesa e ambicies në komunitetin serb në Kosovë që përmes bashkimit politik të realizohen ndryshimet apo interesat e caktuara. Prandaj, qytetarët e komunitetit serb në Kosovë kanë frikë ta shprehin mendimin kritik, kurse autocensura e të gjithë akterëve të shoqërisë po i merr përmasat e epidemisë.

¹¹ Ibid, faqja 121 Përfundimet

¹² Intervista me Goran Avramoviqin, kryeredaktorin e RTV KiM-it – citim: “kritika publike paguhet shumë më shtrëngjtë në ditët e sotme” – faqja 2



Fataliteti i një gjendjeje të tillë për karakterin e vërtetë demokratik të shoqërisë dhe për potencialet saj zhvillimore nuk ka nevojë të provohet. Veprimi politik, si çdo formë tjetër e angazhimit shoqëror, ushqehet nga shumëllojshmëria e ideve dhe filtrimi i tyre përmes dialogut të hapur shoqëror dhe përmes ndonjë forme tjetër të ndërveprimit konsultativ midis qytetarëve dhe liderëve politikë.¹³

Prandaj pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes është parakusht për zhvillim të shoqërisë, dhe aq më parë gjetjet e tilla të hulumtimit OPEN 2020 janë shenjë paralajmëruese për kapacitetin demokratik të shoqërisë serbe në Kosovë, duke treguar se ajo nuk ka potencial thelbësor, përkatësisht një parakusht për ndryshime dhe se nuk ka hapësirë për qytetarë politikisht aktivë.

¹³ Ibid faqja 118

Rezultatet e hulumtimit

Struktura e hulumtimit

Siç e kemi parë, hulumtimi i vitit të kaluar OPEN 2020 në një masë më të madhe është marrë me pasojat sesa me shkaqet e disfatizmit politik në komunitetin serb në Kosovë. Në hulumtimin që gjendet para jush, ne u përpoqëm t'i përmirësojmë këto njohuri dhe t'i përcaktojmë shkaqet dhe përmasat e një tërheqjeje të tillë të qytetarëve nga ideja për tu marrë me politikë. Andaj, hulumtimi nuk është marrë me vlerësimin e punës së opsioneve politike apo individëve të veçantë, por ka pasur për qëllim t'i shqyrtojë elementet dominuese të perceptimit të përgjithshëm të të anketuarve, qytetarëve të moshës madhore nga mjediset serbe në mbarë Kosovë, ndaj përfshirjes në proceset politike si një nga mënyrat për t'i përmbushur qëllimet dhe interesat e tyre. Baza e referencës për matjen e perceptimit të qytetarëve për proceset politike dhe bartësit e tyre ishte Shkalla e Perceptimit Politik (POPS) Kacmar / Ferris 1991¹⁴, e cila u adaptua për t'i matur tri dimensionet e perceptimit të veprimit politik; 1) sjellja e përgjithshme politike, 2) praktikatat mbizotëruese të marrjes me politikë (të ashtuquajturat go along to get ahead¹⁵) dhe 3) perceptimet e pozitës së privilegjuar të aktivistëve politikë. Adaptimi i shkallës është bërë në bazë të nevojave të hulumtimit, thellimit të tezave kërkimore, por edhe të nevojës për monitorim të vazhdueshëm kronologjik të disa prej rezultateve më të rëndësishme nga hulumtimi i vitit të kaluar për të përcaktuar trendet dominuese në perceptimin e qytetarëve. Aplikimi i kësaj shkalle mundësoi nxjerrjen e përfundimeve

apo treguesve të caktuar duke përdorur analiza krahasuese.


Rezultatet: Sjellja e përgjithshme politike

Rezultatet e këtij hulumtimi i konfirmojnë përfundimet kryesore nga Raportii Konsoliduar i OPEN 2020, dhe e tregojnë mosbesimin e thellë të qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë ndaj angazhimit politik, por edhe ndaj bartësve të atij procesi. Kështu, në pjesën e hulumtimit për perceptimin e përgjithshëm të sjelljes politike, të anketuarit treguan, në përqindjen dominuese prej 68,4%, se ata e konsiderojnë veprimin politik si një luftë të paskrupullt, në të cilën e vetmja mënyrë për të përparuar është të "shkelësh të tjerët" (Grafiku 1). Termi bisedor, "shkelje" nënkupton veprime të dëmshme për interesat ose ekzistencën e konkurrentëve (brenda të njëjtës parti politike ose për kundërshtarët). Vetëm 11% të të anketuarve nuk pajtohen me të njëjtin konstatim. Kjo është pothuajse një në dhjetë banorë në mjediset serbe në Kosovë.

¹⁴ Në origjinal: Perception of Organizational politics scale (POPS) – K. Michele Kacmar/ Gerald R. Ferris, 1991

¹⁵ Në përkthim të lirë "mos kundërsh-to për të përparuar" prim.aut.

O Grafiku 1. Në çfarë mase pajtoheni me pikëpamjet e mëposhtme: Njerëzit në politikë përparojnë duke “shkelur të tjerët”




Ajo që të anketuarit e vënë në dukje me këtë përgjigje është perceptimi i fuqishëm se marrja me politikë kërkon një grup të veçantë aftësish dhe modalitete të sjelljeve, të cilat nuk përputhen domosdoshmërisht me normat e zakonshme të sjelljes shoqërore.

Pra, sipas mendimit të tyre, me politikë nuk mund të merret çdokush, por ekskluzivisht grupi i njerëzve që i kultivojnë këto “vlera” të veçanta ose ata që janë gati t’u përshtaten atyre.

Ky përfundim mbështetet nga përgjigjet e të anketuarve në pyetjen e mëposhtme: *A pajtoheni me pohimin se i njëjti grup i njerëzve merret me politikë?* (Grafiku 2). Madje 73.2% të të anketuarve, që është më shumë se dy të tretat, pajtohen me këtë pohim, ndërsa përqindja e atyre që nuk pajtohen me të është 9%.

○ **Grafiku 2.** Me politikë merret grupi i njëjtë i njerëzve



Në pjesën kualitative të hulumtimit, fokus grupeve të mbajtura në komunat e veriut të Kosovës, ky qëndrim i qytetarëve u është shpjeguar edhe me disa rrethana sociale objektive karakteristike për komunitetin serb në Kosovë, në radhë të parë me mungesën e potencialit intelektual të komunitetit serb në Kosovë, të varfëruar në vitin 1999 dhe më vonë nga trendet e konsiderueshme negative të migracionit¹⁶.



Në të njëjtin fokus grup, njëri nga të anketuarit tha se “elitat politike ndryshojnë paralelisht me ndryshimin e pushtetit në Beograd, por që në thelb ai është i njëjti grup i njerëzve që janë bërë të varur nga fuqia politike dhe privilegjet”.¹⁷


¹⁶ Fokus Grupi Mitrovica e Veriut, raporti, faqja 2.

¹⁷ Ibid, i anketuari A.3, raporti nga fokus grupi Mitrovica e Veriut

Sipas të anketuarve, ky ekskluzivitet në veprim politik nuk bazohet domosdoshmërisht në kriteret e kompetencës, aftësisë dhe rezultateve pozitive. është, pothuajse gjysma e të anketuarve, qytetarëve të moshës së rritur (madhore) të komunitetit serb në Kosovë, nuk pajtohen me pohimin se me politikë merren personat përgjithësisht kompetent (45.6%), ndërsa përqindja e atyre që konsiderojnë se

përfaqësuesit e tyre politikë janë kompetentë për punë të cilat i kryejnë është pak më e ulët se 33%, pra pothuajse një e treta e të anketuarve. (Grafiku 3).

O Grafiku 3. Duke shikuar në përgjithësi me politikë merren njerëzit kompetentë




Cilat janë karakteristikat e politikanëve sipas perceptimit të të anketuarve?

Madje 68.6 përqind të të anketuarve pohojnë se politikanët manipulojnë me fakte në prezantimin e punës së tyre (grafiku 4 më poshtë).



Ndoshta tregues më i mirë është përqindja e atyre që nuk pajtohen me një pohim të tillë, e cila është vetëm pak më e madhe se gabimi statistikor, është 8.6 për qind, nga të cilët vetëm 0.6% të të anketuarve pohojnë decidivisht (nuk jam fare dakord) se ky konstatim nuk është i vërtetë.


O Grafiku 4. Politikanët manipulojnë me fakte në mënyrë që politika e tyre të duket mirë



Perceptimin e qytetarëve se nuk duhet t'u besohet politikanëve e plotësojnë edhe përgjigjet në pyetjen e radhës në sondazh, e cila thotë: "A jeni dakord që politikanët kryesisht e tregojnë të vërtetën dhe përpiqen t'i mbajnë premtimet", gjë me të cilën pothuajse

gjysma e të anketuarve nuk pajtohen (ose plotësisht nuk pajtohen) 47.8% (Grafiku 5). Në të njëjtën pyetje janë përgjigjur pozitivisht saktësisht 30% të qytetarëve që kanë marrë pjesë në sondazh.

O Grafiku 5. Politikanët kryesisht e tregojnë të vërtetën dhe përpiqen t'i plotësojnë premtimet





Pra, si përfundim në këtë pjesë të hulumtimit, mund të cekim në mesin e qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë mbizotëron bindja se marrja me politikë me vete bart domosdoshmërisht edhe manipulimin me të vërtetën, faktet, premtimet zgjedhore.

Me pak fjalë, edhe pse jo decidivisht, qytetarët e përshkruajnë sjelljen karakteristike për popullizëm politik në formën e tij më të rreptë, përkatësisht në retorikën demagogjike. Perceptimet e tilla janë karakteristike në një mjedis në të cilin kultivohet imazhi i një shoqërie të ndarë në njerëz të zakonshëm (të ndershëm) dhe elitë politike të korruptuar.¹⁸

Korrupsioni endemik i cili ekziston jo vetëm në komunitetin serb, por edhe në shoqërinë kosovare dhe në një serë vendesh të Ballkanit Perëndimor¹⁹ nuk është i rezervuar ekskluzivisht për partitë politike, edhe pse bashkimi dhe veprimi politik është me të vërtetë mënyra më e shpejtë për të arritur deri te pozitat dhe funksionet që e mundësojnë një gjë të tillë. Duke folur për këtë fenomen brenda komunitetit serb në Kosovë, Dimitrijeviqi, kryeredaktori i Radio Gorazhdecit, thotë se para dy dekadash (pas vitit 1999 prim.aut) politikanët kanë treguar jotransparencë sistematike në menaxhimin e financave publike.²⁰ Sipas mendimit të Dimitrijeviqit *afërat dhe tenderët e shumtë, të cilët përsëriteshin për të njëjtën gjë, kanë*

*kontribuar që zyrtari publik-politikani të bëhet sinonim i korrupsionit në Kosovë.*²¹


Pra, përfundimi unik për pjesën e parë të hulumtimit dotë konfirmontetë ashtu quajturën gjendjen e njohur përgjithësisht, se qytetarët nuk kanë besim te liderët e tyre politikë dhe dyshojnë se sjellja korruptive, manipuluese është kthyer në modus operandi në profesionin politik. E transferuar në një kontekst real, qytetarët e komunitetit serb në Kosovë konsiderojnë se marrja me politikë është e mundur vetëm duke i pranuar modelin e sjelljes i cili konsiderohet “jo etik” në çdo sferë tjetër të jetës së tyre.

18 Smith J. 2011 – në origjinal Political populism in transitional societies. Page 18

19 <https://www.balkanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/Kosovo-the-lost-battle-against-corruption-209245>

20 Intervista Darko Dimitrijeviq – citim: “Prej dy dekadash pothuajse të gjithë ata që janë marrë me politikë dhe kanë ushtruar funksione publike i kanë lënë mënjanë financat e institucioneve publike, larg syrit të publikut.”

21 Ibid, pyetja e njëjtë




Rezultatet: Praktikrat mbizotëruese të marrjes me politikë

Në vazhdim të hulumtimit, më hollësisht jemi marrë me pikëpamjen e qytetarëve pikërisht ndaj atyre modeleve të sjelljes që janë karakteristike për veprimin politik. Siç do ta shihni në tekstin e mëtejshëm, gjetjet në të vërtetë janë interesante.

Para së gjithash, të anketuarit konsiderojnë se marrja me politikë domosdoshmërisht do të thotë t'i japësh prioritet interesave partiake krahas interesave të komunitetit.

Andaj, në pyetjen sa pajtohen me pohimin se: “Politikanët e bëjnë atë që është e mirë për qytetarë, e jo atë që i urdhëron shefi”, 47.6% të të anketuarve, pra pak më pak se gjysma, pohojnë se nuk pajtohen me një konstatim të tillë (Grafiku 6). Vetëm rreth një e katërta e qytetarëve (25.7%) konsideron se kjo gjë është e saktë.

O Grafiku 6. Politikanët e bëjnë atë që është e mirë për qytetarë, e jo atë që i urdhëron shefi






Pra, sipas pikëpamjes së qytetarëve, besnikëria “e verbër” partiake është një nga karakteristikat themelore të profesionit politik. Nëse kujtojmë se një nga detyrat kërkimore ishte vërtetimi i potencialit të pjesëmarrjes qytetare në proceset politike si një mjet legjitim për përmbushjen e qëllimeve dhe

interesave të tyre, ky perceptim sigurisht që ka ndikim demotivues në qytetarët.

Sipas rezultateve të hulumtimit, pikërisht ky nënshtrimi ndaj interesave partiake apo interesave të liderëve të saj është ajo që qytetarët e shohin si formë e sjelljes përmes së cilës më së shpejti përparohet në nomenklaturën partiake. Kështu, madje 61.2% të të anketuarve pajtohen me pohimin se mënyra më e mirë për të përparuar në politikë është ta kënaqësh liderin e partisë (Grafiku 7). Vetëm 13.2% të të anketuarve nuk pajtohen me një pohim të tillë.

O Grafiku 7. Mënyra më e mirë për të përparuar në politikë (parti) është shkuarja për shtati liderit të partisë



Andaj, rezultatet tregojnë se qytetarët nuk e perceptojnë angazhimin politik si metodë me të cilën mund të realizohen ide të reja apo të paraqiten pikëpamje të ndryshme të interesave të qytetarëve, sepse brenda njësive organizative të partive politike, kultivohen servilizmi, nënshtrimi, kurse interesat personale të liderëve të saj kanë përparësi mbi të mirën publike. Ky është gjithsesi një faktor demotivues për përfshirjen e qytetarëve në politikë, por nuk është i vetmi.

Përmasat reale të këtij problemi mund të kuptohen vetëm nëse ky përfundim shihet në kontekstin e raporteve të partive politike ndaj kundërshtarëve, të cilat karakterizohen, siç e shtjelluam (elaboruam) në fillim të këtij studimi, me presione sistematike, njollosje (përbaltja) publike, rreziqe ekzistenciale (humbja e vendit të punës, e të ngjashme). Kjo tregon që qytetarët, jo vetëm që nuk kanë hapësirë që përmes përfshirjes në çështje ekzistuese të merren edhe me problemet e veta ose me problemet e komunitetit, por kjo gjë nuk është e mundur as përmes bashkimit të pavarur politik, për shembull duke krijuar nisma qytetare ose parti, programi i të cilave dallon nga programet e opsionit dominues politik në komunitetin serb në Kosovë. Më saktësisht, është e mundur, por me rreziqe të mëdha personale që sjell veprimi opozitar, dhe një nga rreziqet është shpallja e kundërshtarëve politikë për tradhtarë kombëtarë^{22 23 24 25}. Në këtë mënyrë, hapësira për t'u marrë me politikë apo aktivizim politik në komunitetin serb në Kosovë është e kufizuar në një masë të madhe vetëm brenda ose në përputhje me politikën e opsionit politik pushtetar, i cili në kontekstin në fjalë është gjithmonë opsioni

politik i cili është në pushtet në Beograd. Sipas përgjigjeve në intervistat e bëra në pjesën kualitative (cilësore) të hulumtimit, në thelb të një raporti të tillë qëndron fakti se serbët në Kosovë në masë të madhe shihen si mishërim i politikës së Republikës së Serbisë ndaj Kosovës. Ky harmonizim politik mes serbëve të Kosovës dhe Republikës së Serbisë është një manifestim i natyrshëm i lidhjeve më të gjera kombëtare, shoqërore, etnike apo kulturore në këtë relacion²⁶. Megjithatë, siç e kemi shpjeguar tashmë, korniza e veprimit të tillë të sinkronizuar nuk janë parimet strategjike kombëtare të harmonizuara, por, sipas rregullit, interesi i partive që aktualisht janë në pushtet në Serbi. Në rrethana të tilla, çdo pluralizëm politik ideologjik interpretohet me keqdashje si tradhti ndaj interesave kombëtare, kurse ndaj bartësve të këtyre ideve “ushtrohet” presioni i rëndë shoqëror. Disa bashkëbisedues nga komuniteti serb në Kosovë pohojnë se ky raport ndaj jo-bashkëmendimtarëve politikë ka një qëllim shtesë, që ta largojë vëmendjen e publikut nga kritikata ndaj performancës së pushtetit në disa tema tjera. Kështu, sipas Goran Avramoviqit, kryeredaktorit të RTV KiM-it, tregimi për “tradhtinë dhe tradhtarët” (...) vendoset, në radhë të parë, për të shkaktuar panik dhe për ta krijuar ndjenjën e cenimit në shoqëri. Më pas, me siguri, pason nevoja që përmes të folurit për idealet më të larta dhe patriotizmin të “mbulohen” prapësitë dhe krimet (veprat e këqija) vetanake²⁷. Avramoviqi shton se serbët e Kosovës janë kryesisht duke zbatuar pa kundërshtim urdhrat e regjimit në pushtet nga Beogradi. Nga terreni drejt Beogradit, për një kohë të gjatë, veçanërisht jo në vitet e fundit nuk ka pasur nisma të rëndësishme.²⁸

22 <https://www.danas.rs/ljudi/nenad-rasick-na-meti-srpske-liste/>

23 <https://www.republika.rs/vesti/srbija/260175/dilas-ova-rada-pokazala-da-je-izdajnik-sa-kurtijem-gradimo-nezavisno-kosovo-prava-srba-nam-nisu-prioritet>

24 <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/rakic-stojanovic-u-bolesnoj-borbi-za-vlast-ugrozio-zivot-sudiji-labanu-17-8-2021>

25 <https://www.danas.rs/vesti/politika/danas-dve-godine-od-spota-kojim-je-oliver-ivanovic-zigosan-kao-izdajnik/>

26 Nga autori i njëjtë: Serbët e Kosovës në të dy anët e lumit: ndarjet për të cilat heshtet, Radio KiM, 11 tetor 2021 <https://www.radiokim.net/vesti/analiza/kosovski-srbi-sa-obe-strane-reke-podele-o-kojima-se-cuti.html>

27 Citimet nga intervista me Goran Avramoviqin – sidomos gjatë disa viteve të fundit nga përfaqësuesit e zgjedhur (e e meruar) të Listës Serbe, e cila në të vërtetë është vetëm emri lokal (kosovar) për Partinë Përparimtare Serbe.

28 Ibid

Bashkëbiseduesit e tjerë nga pjesa kualitative (cilësore) e hulumtimit (fokus grupet dhe intervistat) kryesisht e konfirmojnë këtë raport vartës ndërmjet serbëve të Kosovës dhe Beogradit zyrtar, por e bëjnë dallimin mes idesë thelbësore për përfaqësimin e përbashkët dhe praktikave që janë zhvilluar nga ajo. Kështu, sipas Aleksandër Rapajiqit, drejtorit të programit të OJQ-së ACDC, “ideja e themelimit të Listës Serbe është përgjithësisht e mirë, ajo siguron që komuniteti serb të mos përplasat rreth zgjedhjeve dhe e siguron ndikimin më i fortë në institucionet qendrore, problemi është që në kuadër të Listës Serbe nuk ka vend për pluralizëm të mendimeve.²⁹ Të anketuarit nga fokus grupet e organizuara në mjediset në jug të lumit Ibër konsiderojnë se “politika uniforme të cilën e udhëheq Beogradi është krijuar në bazamentet e pozitës dhe të interesave të komunitetit serb në veri të Kosovës dhe në një numër të madh të rasteve i neglizhon interesat e komunitetit serb në jug.” (të lumit Ibër- prim.aut).³⁰

Andaj, në përfundim të hulumtimit tregohet se modelet dhe praktikat aktuale (në një masë të caktuar dhe historikisht) të veprimit politik të serbëve të Kosovës, nuk e reflektojnë pluralizmin ekzistues të interesave të komunitetit, dhe që as nuk janë krijuar kushtet objektive shoqëro-politike që të flitet për këto interesa lirshëm, haptazi dhe publikisht. Në rrethana të tilla, angazhimi politik reduktohet kryesisht vetëm në një opsion politik, kurse praktikat tregojnë që ai shërben vetëm për arritjen e interesave personale, e jo të atyre të përgjithshme. Këtë fenomen jemi përpjekur ta shpjegojmë në vijim të hulumtimit.

Perceptimet e pozitës së privilegjuar të aktivistëve politikë

Rrethanat në të cilat zhvillohet jeta politike e serbëve të Kosovës dhe të cilat, siç e përshkruam në pjesën paraprake të hulumtimit, manifestohen me mbyetje sistematike të pluralizmit politik ose aktivizmit të pavarur qytetar, kanë rezultuar në krijimin e një shoqërie me veçori të shoqërisë autokratike në një organizim shoqëror formalisht demokratik.



Një marrëdhënie e tillë pothuajse paradoksale midis realitetit dhe organizimit formal manifestohet, për shembull, përmes një procesi formal demokratik zgjedhor, në të cilin qytetarët detyrohen të votojnë për një opsion politik, ose përmes legjislacionit formal i cili e garanton lirinë e bashkimit politik, por që zakonisht çon deri te njollosja agresive mediale ose deri te presionet e llojeve të tjera ndaj kundërshtarëve.

Andaj, kemi të bëjmë më një simulim të demokracisë, e cila me dekada të tëra e karakterizon jetën politike në komunitetin serb në Kosovë dhe i ka të gjitha parakushtet të bëhet model i saj i veprimit politik, nëse tashmë ende nuk është bërë. E rezultatet e këtij hulumtimi e dëshmojnë këtë gjë pa dyshim. Kështu, për shembull, vetëm çdo i pseti i anketuar (21.2%) nuk pajtohet me konstatim


29 Citati nga intervista me Aleksandër Rapajiqin.

30 Raporti nga fokus grupi Graçanica, 21.01.2022

se është më lehtë të heshtësh sesa të luftosh kundër sistemit (Grafiku 8 – më poshtë). Pothuajse 30% të të anketuarve (nuk e di ose nuk dua të përgjigjem) nuk kanë dashur ta

përgënjeshtrojnë të njëjtin pohim, kurse me atë pohim pajtohen rreth 50% të qytetarëve të anketuar nga komuniteti serb në Kosovë.

O Grafiku 8. Është më lehtë të heshtësh se sa të luftosh kundër sistemit



Në pjesën kualitative (cilësore) të hulumtimit, të anketuarit treguan se modeli i mbytjes së kritikës publike në një masë më vogël ose më të madhe ekzistonte mu nga fillimi i konfliktit. Sipas mendimit të Goran Avramoviqit, kryeredaktorit të RTV KiM-it, dallimet në pasojë megjithatë ekzistojnë dhe tregojnë një trend të përkeqësimit i cili e arriti kulmin me shfaqjen e Listës Serbe. Sipas mendimit të Avramoviqit “kritika publike paguhet

shumë më shtrenjtë në ditët e sotme.”³¹ I njëjti burim indirekt tregon se modeli i sjelljes së liderëve politikë në komunitetin serb kryesisht i ka ndjekur trendet dominuese të lirive të njëjta në shoqërinë serbe në Serbi. Kështu, Avramoviqi pohon: “Përshtypja ime është se serbët e Kosovës ishin më të lirë për të kritikuar në kohën e Zoran Gjingjiqit (Zoran Đinđić) në pozitën e kryeministrit të Serbisë dhe se situata po përkeqësohej vazhdimisht pas vdekjes së tij.”³²


31 Intervista Goran Avramovicq – kryeredaktori i RTV KiM-it, faqja 2

32 Ibid

Që qytetarët e perceptojnë veprimin e pavarur politik dhe shprehjen publike të qëndrimeve politike si kërcënim/rrezik për sigurinë e tyre, dëshmojnë edhe përgjigjet e të anketuarve në pyetjen: "A pajtoheni me konstatim se është më e sigurt ta mendosh atë që e thonë

të tjerët sesa të mendosh me kokën tënde?" (Grafiku 9 - më poshtë). 44% të të anketuarve pajtohen me këtë konstatim (kumulativisht pajtohem / plotësisht pajtohem) dhe pak më pak se 30% të tyre e pohojnë të kundërtën.


O Grafiku 9. Është më sigurt ta mendosh atë që thonë të tjerët sesa të mendosh me kokën tënde



Andaj, rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se qytetarët e komunitetit serb në Kosovë, jo vetëm që tregojnë mungesë të përgjithshme të motivimit për t'u përfshirë në mënyrë aktive në proceset në komunitetet e tyre, por njëkohësisht edhe që e konsiderojnë servilizmin politik si model sjelljesh të pranuar përgjithësisht - si një model i cili u mundëson

realizimin e interesave dhe qëllimeve personale. Kështu mendojnë pothuajse dy të tretat e të anketuarve, me saktësisht 65.8% të tyre (Grafiku 10), e me këtë gjë nuk pajtohen pak më shumë se 10% të të anketuarve.

O Grafiku 10. Është shumë më lehtë të keni sukses në jetë nëse jeni në marrëdhënie të mira me politikanët



Lidhja e afirmimeve shoqëro-ekonomike të individëve me vullnetin e politikanëve, shfuqizon barazinë në shoqëri si një nga parimet bazë të demokracisë. Kjo do të thotë më tej se qytetarët konsiderojnë se burimet publike janë në dispozicion vetëm për një grup të privilegjuar të njerëzve dhe se shpërndarja e tyre nuk përkufizohet nga procedurat e drejta dhe të parashikueshme ligjore, por në atë proces

favorizohen bashkëmendimtarët politikë.

Me fjalë të tjera, këto përgjigje të të anketuarve tregojnë për veprime korruptive të kudogjendura dhe nepotizëm në shpërndarjen e burimeve publike (dhe punëve). Ky përfundim nuk është i ri në vetvete. Shumë raporte të panumërta relevante ndërkombëtare e konfirmojnë këtë pikëpamje të të anketuarve, dhe e vënë në dukje nivelin e lartë të korrupsionit në Kosovë, duke e quajtur atë endemik.³³ Raporti i Bashkimit Evropian për progresin e Kosovës në integrimet e BE –së nga viti 2021, në mënyrë më precize cek se korrupsioni mbetet një nga sfidat kryesore në veri të Kosovës.³⁴

33 Ambassador Delawie's Remarks at AmCham Discussion on Fighting Corruption and Business Ethics, October 2017 <https://xk.usembassy.gov/ambassador-delawies-remarks-amcham-discussion-fighting-corruption-business-ethics/>

34 EU Progress Report for Kosovo (EU Raporti Vjetor për përparimin e Kosovës) <https://ec.europa.eu/neigh->


Një tipar i praktikës politike në komunitetin serb që shpesh është objekt i ankesave të qytetarëve është rishpërndarja e vendeve të punës në ndërmarrjet publike, si ato që funksionojnë në sistemin ligjor dhe administrativ të Republikës së Serbisë, ashtu edhe atë në institucionet publike të Kosovës. Në të dyja rastet, ekzistojnë praktikatat e rrënjosura thellë se këto vende të punës u caktohen bashkëlloftëtarëve bashkëmendimtarëve të

partisë³⁵. Rezultatet e sondazhit të këtij viti tregojnë se rreth 64.8% të të anketuarve nga komuniteti serb në Kosovë konsiderojnë se besnikëria politike është mënyra e vetme për të gjetur një vend pune. Vetëm 12% të të anketuarve nuk pajtohen me të njëjtin pohim.

[bourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en](#), faqja 5, përmbledhja ekzekutive.

35 <https://kfos.org/en/publications/110/karakteristike-otvorenog-drustva-u-srpskoj-zajednici-na-kosovu>, faqja 119, Liria e bashkimit politik

O Grafiku 11. E vetmja mënyrë për të gjetur punë të shtetit ose për t'u avancuar në punë është besnikëria politike



Pra, në mesin e qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë ekziston një bindje e rrënjosur thellë se një vend pune në sektorin publik, si sinonim i sigurisë financiare të një individi dhe familjes së tij, mund të fitohet vetëm në një mënyrë, dhe ajo është besnikëria partiake.

Në Raportin e konsoliduar të OPEN 2020³⁶ është diskutuar për fenomenin e rishpërndarjes partiake të funksioneve si një praktikë që shkon përtej kornizave lokale dhe e cila është e pranishme kudo në botë. Raporti nuk nxjerr një përfundim definitiv nëse inkadrimi partiak është në thelb një praktikë e paligjshme, por tregon se përmasat e saj në komunitetin serb në Kosovë janë aq të mëdha dhe të përhapura sa i tejkalojnë standardet e pranueshme demokratike³⁷ dhe madje përfaqësojnë një nga mekanizmat bazë që ndikojnë në votuesit.

Në pjesën kualitative (cilësore) të hulumtimit, bashkëbiseduesit theksuan një tjetër pasojë shkatërruese të kësaj praktike, dhe ajo është prioritetizimi i besnikërisë kundrejt ekspertizës në shpërndarjen e funksioneve dhe vendeve të punës publike. Sipas mendimit të Darko Dimitrijeviqit, kryeredaktorit të Radio Gorazdecit, një praktikë e tillë jo vetëm që i shkatërron kapacitetet zhvillimore të shoqërisë, por gjithashtu ka një ndikim të fortë në largimin e njerëzve të rinj dhe të arsimuar nga komuniteti serb, të cilët në një numër gjithnjë e më të madh po largohen nga Kosova, gjë që edhe më tej e varfëron potencialin shoqëror.³⁸

Praktika e rishpërndarjes partiake të burimeve publike ndikon jo vetëm në sektorin publik, por ka pasoja edhe për sektorin privat. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për qasje në programe të mbështetjes ose për qasje të privilegjuar në tenderët e prokurimit publik, apo ndonjë formë tjetër të klientelizmit, ka


shumë mënyra që ndërmarrësit t'i fitojnë privilegjet e caktuara përmes “marrëdhënieve të mira” me politikanët. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e hulumtimit tonë, në bazë të cilave pothuajse dy të tretat e të anketuarve, (65,6%) konsiderojnë se është e dobishme për biznes privat të kesh marrëdhënie të mira me politikanët, kurse vetëm 10,2% të qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë që kanë marrë pjesë në këtë studim nuk pajtohen me këtë pohim.

36 Ibid, faqja 119

37 Ibid faqja 120

38 Intervista me Darko Dimitrijeviqin, citim: “pasojat e punësimit partiak janë shkuarja e të rinjve, korrupsioni, nepotizmi, varfëria, shitja e pronave dhe largimi nga Kosova.”


Grafiku 12. Marrëdhëniet e mira me politikanë janë të mira për biznes privat



Andaj, perceptimi dominues mes qytetarëve është se marrja me politike i mundëson privilegjet e çdo lloji, duke e përfshirë edhe fitimin e dobisë materiale.

Me këtë pajtohet, deri më tani, numri më i madh i të anketuarve, madje 70% (Grafiku 13).

O Grafiku 13. Politika është profesion fitimprurës



Duke i interpretuar rezultatet e tilla, njëri nga të anketuarit në pjesën kualitative (cilësore) të hulumtimit pohon se:



“profesioni - politikan - është shumë i dobishëm, qytetarët mund të shohin se politikanët fitojnë shumë mirë dhe se jetojnë mirë, shpesh në mënyrë shumë

më luksoze se sa ua lejojnë të ardhurat bazë, dhe kjo gjë çon në dyshim se keqpërdorimi dhe nepotizmi ekzistojnë, duhet të pranoj se edhe unë pajtohem me mendim të tillë.”³⁹


Prandaj, hulumtimi në përgjithësi tregon pakënaqësi të madhe të qytetarëve me punën e përfaqësuesve të tyre politikë. Duke ndërlidhur të dhënat statistikore, kemi verifikuar se një bindje e tillë është njëloj e pranishme

³⁹ Intervista me Aleksandër Rapajiqin, drejtorin e programit të OJQ-së ACDC

te qytetarët, pavarësisht nga vendbanimi i tyre (në veri apo në jug të lumit Ibër), niveli i arsimimit apo statusi i punësimit. Megjithatë, duke i ndërlidhur të dhënat në bazë të moshës së të anketuarve, e kemi verifikuar se ekziston trendi i rritjes së mbështetjes për përfaqësuesit politikë të komunitetit serb me rritjen e moshës së të anketuarve. Në grafikun 14 (më poshtë)

të dhënat tregojnë se numri i të anketuarve në popullatën mbi 65 vjeçe që ka një opinion pozitiv për tregues të caktuar të kryerjes së përgjegjshme të funksioneve politike, është pothuajse dyfish më i lartë se në krahasim me popullatën e re (nga 18 deri në 35 vjeçe).

O Grafiku 14. Përçindja e të anketuarve sipas moshës të cilët nuk pajtohen (ose fare nuk pajtohen) me pohimet në vijim



Pra, një nga përfundimet e këtij hulumtimi është se perceptimet negative për veprim politik, ndonëse janë të pranishme te të anketuarit të të gjitha moshave, janë veçanërisht të theksuara tek popullata më e re, te të anketuarit nga moshja 18 deri në 35 vjeç. Kështu për shembull, hulumtimi tregon se madje 54% të të rinjve (18-35 vjeç) konsiderojnë se është më e lehtë të heshtësh sesa të luftosh kundër sistemit, ndërsa vetëm 25% të të anketuarve mbi moshën 65 vjeç pajtohen me këtë. Në mënyrë të ngjashme, pothuajse gjysma e të rinjve të moshës 18 deri

në 35 vjeç në Kosovë, 49.7% të tyre, konsideron se është më e sigurt të mendosh atë që thonë të tjerët sesa të mendosh me kokën tënde në drejtimin e ndërtimit të qëndrimeve politike dhe të afirmimit të tyre shoqëror.

Defetizmin dhe indiferencën e dukshme të të rinjve në komunitetin serb në Kosovë bashkëbiseduesit në pjesën kualitative të hulumtimit e shpjegojnë në mënyra të ndryshme. Sipas mendimit të disave, ky pasivitet i të rinjve është pasojë e llojeve të ndryshme të presioneve, shantazheve dhe kërcënimeve që e shoqërojnë çdo përpjekje

të veprimit të pavarur të të rinjve⁴⁰. Në anën tjetër, Aleksandër Rapajiq pohon se këto të gjetura nuk janë plotësisht të sakta dhe se *“politika në kuadër të komunitetit serb në Kosovë është shumë e zakonshme dhe shumë njerëz merren me te, madje edhe të rinjtë, e kohëve të fundit mund të shohim që edhe shumë të rinj kanë ardhur në funksione.”*⁴¹

Megjithatë, një qendrim i tillë mbeti i vetmuar në mesin e pjesëmarrësve të tjerë të fokus grupeve dhe intervistave, të cilët pohojnë se pasiviteti i popullatës së re në komunitetin serb për t'i përmbushur qëllimet dhe interesat e tyre përmes veprimit të pavarur politik është një model sjelljeje jashtëzakonisht i theksuar.⁴²

Fokusi i veçantë: Raporti mes organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe politikanëve

Organizatave të shoqërisë civile, si përfaqësues të qytetarëve dhe interesave të tyre, luajnë një rol aktiv dhe shumështrësor në dinamikën shoqëro-politike në shoqëritë demokratike. Para së gjithash, ky është një rol në përforcimin e cilësisë dhe promovimin e demokracisë⁴³, monitorimin e përfaqësuesve institucionalë dhe politikë në aplikimin e parimeve ligjore dhe demokratike, si dhe rol në rritje në krijimin e politikave publike e të ngjashme. Në këtë cilësi, shoqëria civile vepron domosdoshmërisht në skenën politike, dhe është pjesë përbërëse e saj, ndaj përmendet, gjithnjë e më shpesh, si

40 Intervista me Darko Dimitrijeviqin, citim: “Janë pasiv për shkak të shembujve të presioneve, shantazheve dhe kërcënimeve të shumta me pushim nga puna te tyre ose anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre nëse e kundërshtojnë (kritikojnë) Listën Serbe.”

41 Intervista me Aleksandër Rapajiqin

42 Fokus grupi – Veriu i Kosovës – përgjigja e të anketuarve 8 – faja 4

43 Anders Uhlin, 2009 në origjinal - [Civil Society Elites: Comparing Elite Composition, Reproduction, Integration and Contestation in European Civil Societies](#);

pjesë përbërëse e procesit të qeverisjes së shoqërisë. Kështu, disa autorë madje pohojnë se sektori politik dhe ai civil janë po aq të rëndësishëm për konsolidimin demokratik të një shoqërie⁴⁴ dhe se marrëdhëniet e tyre të ndërthurura janë pasojë e domosdoshme e një ndarjeje të tillë shoqërore të roleve.

Pjesëmarrja e sektorit civil në jetën politike të një shoqërie është temë e diskutimeve të gjera në qarqet akademike, ku qëndrimet e dy shkollave të mendimit ende nuk kanë afruar; njëra që konsideron se shoqëria civile në përmbushjen e rolit të saj shoqëror duhet të krijojë dhe të kultivojë marrëdhënie të ngushta me përfaqësuesit politikë të qytetarëve⁴⁵ dhe tjetra e cila konsideron se kjo marrëdhënie duhet të mbetet në distancë për t'ia mundësuar sektorit civil pavarësinë e nevojshme në punën e tij për konsolidim të demokracisë⁴⁶. Dilema nuk është zgjidhur deri në ditët e stome. Nga këndvështrimi i veprimit të OSHC-ve si një formë e lëvizjes shoqërore, nismat e organizatave të shoqërisë civile, kohë pas kohë i kanë vetitë e veprimit opozitar, veçanërisht nëse arrijnë e qëllimeve të avokimit OSHC-të mbështeten në mobilizimin më të gjerë të shoqërisë dhe kritikën e politikave të bartësve të.

Pikërisht një karakter i tillë i perceptimit të organizatave të shoqërisë civile është mbizotërues në demokracitë në tranzicion dhe rrjedhimisht në vendet e Ballkanit Perëndimor, pra në shoqëritë ku praktikat demokratike nuk janë jetësuar (nuk kanë zënë rrënjë) plotësisht dhe institucionet shtetërore nuk janë të prira ndaj metodave pjesëmarrëse të vendimmarrjes dhe formulimit të politikave publike. Në shoqëri të tilla, puna e sektorit civil shpesh perceptohet nga ana e pushtetit si kërcënim dhe mohohet dhe pengohet në mënyra të ndryshme⁴⁷. Në shoqërinë kosovare, ka dallime të mëdha në

44 Linz & Stepan, 1996

45 Linz, 1996; Morlino, 1998

46 (Katz & Mair, 1995; Kitschelt, 2000

47 Cenzolovka- Fushata “mercenarët e huaj” - <https://www.cenzolovka.rs/tag/kampanja-strani-placenici/page/2/>

mes të komunitetit shqiptar dhe atij serb në marrëdhënie të politikanëve me sektorin civil.


Organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin shqiptar deri në një masë kanë arritur të fitojnë trajtim afirmativ nga bartësit e pushtetit⁴⁸, prandaj, edhe pse janë larg nga gjendja ideale, ato shihen, gjithnjë e më shumë, si një partner efektiv dhe me ndikim në procesin e vendimmarrjes. Në anën tjetër, sektori civil që vepron në komunitetin serb në Kosovë asnjëherë nuk ka arritur të imponohet si partner kredibil për pushtetarët në komunitetin e vet, por as në nivelin qendror.

Ka disa arsye për këtë gjë, nga mungesa e burimeve adekuate njerëzore të nevojshme për të formuluar zgjidhje për problemet e vështira me të cilat përballen, mungesa e përfaqësimit që gëzojnë OSHC-të në komunitet e deri te perceptimet stereotipike me të cilat shikohet në sektor civil nga përfaqësuesit politikë, madje dhe qytetarët e shoqëria në tërësi⁴⁹. Hulumtimi OPEN 2020 e identifikoi një problem thelbësor të besimit që e gëzon sektori civil serb në komunitet, interesat e të cilit pretendon se i mbron. Grafiku 15 e ilustron këtë:

48 Adrian Kastrati, në origjinal Civil Society Development and its impact on democratization process in Kosovo, hyrje, faqja 5

49 OPEN 2020 Raporti i konsoliduar – Liritë e bashkimit – sektori civil në komunitetin serb në Kosovë, Kapitulli II, faqja 98, hyrje.

O Grafiku 15. Qëndrimet e qytetarëve për integritetin e organizatave të shoqërisë civile të cilat punojnë në mjediset serbe në Kosovë – OPEN 2020





Pra, qytetarët në një përqindje të konsiderueshme kanë rezerva ndaj vendosjes thelbësore të OSHC-ve për të mbrojtur interesat e komunitetit, ata konsiderojnë se akterët e tjerë shoqëror kanë një ndikim të madh në agjendën e shoqërisë civile. Kështu, më shumë se një e treta e të anketuarve (37%) konsiderojnë se partitë politike e kontrollojnë në një masë të konsiderueshme punën e OSHC-ve, kurse qytetarët i tregojnë përmasat e ngjashme mosbesimi në raportin e OSHC-ve ndaj agjencive donatore.

Edhe pse në pjesën cilësore të hulumtimit të anketuarit nuk mundën plotësisht të arsyetojnë nëse qëndrimet e tilla janë të bazuara në realitet, ekspertët që e njihin këtë dinamikë pohojnë se në rrethanat e dhëna raporti ndërmjet OSHC-ve që veprojnë në mjediset serbe në Kosovë dhe përfaqësuesve të tyre politikë nuk tregojnë modele të dukshme. Sipas përfundimit të një prej disa fokus grupeve të realizuara në kuadër të këtij hulumtimi⁵⁰, nuk ekziston asnjë përpjekje strukturore e synuar e partive politike për të kontrolluar OJQ-të e caktuara, por dinamika e kësaj marrëdhënieje ndryshon në varësi të prirjeve individuale dhe preferencave personale të disa liderëve të OSHC-ve ndaj opsioneve të caktuara politike apo nga aftësia e tyre për ta ruajtur pamjen e një mbrojtësi të besueshëm të interesave

të qytetarëve pa kritika kuptimplota dhe të përcaktuara saktësisht ndaj pushtetit⁵¹.

Pikërisht ky rol i kritikëve të pushtetit, që buron nga natyra e rolit të OSHC-ve si një faktori korigjues në shoqëri, është një nga kriteret bazë për klasifikimin brenda sektorit civil i cili vepron në komunitetin serb. Sipas fjalëve të njërit prej liderëve të shoqërisë civile (kërkesa për anonimitet), modelet e mbyjtjes së kritikës dhe opozitës në spektrin politik brenda komunitetit serb (përmes presionit) aplikohen edhe ndaj akterëve të tjerë shoqërorë, mediave dhe shoqërisë civile. Sipas fjalëve të tij/të saj, OSHC-të janë (vetëm⁵²) deri diku të lira ta kritikojnë pushtetin, shumë më shumë atë qendror (shqiptarët e Kosovës) dhe shumë më tepër për çështje që përfaqësuesit politikë të komunitetit serb nuk i përjetojnë si të rëndësishme/ndjeshme. *Kritika e përgjithshme kryesisht nuk shkakton reagim, ndërsa të kritikuarit i veprimeve/lëvizjeve/deklaratave individuale të partisë apo anëtarëve të saj rezulton me një lloj reagimi, p.sh. komunikatat.*⁵³ Me fjalë të tjera, bashkëbiseduesit e përshkruajnë formën klasike të autocensurës (të liderëve civilë) në veprimin dhe dialogun publik.

I përballur me presione të pashmangshme, një numër i madh i OSHC-ve nga komuniteti serb e zgjedh “veprimin apolitik”⁵⁴, i cili është një term i përdorur për t’u përshkruar politika e përmbajtjes nga kritika e pushtetit dhe e vënies së fokusit programor në çështje më të lehta sociale. Një strategji e tillë i lejon ato të funksionojnë pa pengesa brenda komunitetit lokal dhe në disa rrethana ua lehtëson qasjen në fonde, ua mundëson një gamë më të gjerë veprimesh (programet që kërkojnë partneritet publiko-civil) ose në disa situata ua siguron rolin e zbatuesit të drejtpërdrejtë në programet e qeverisjeve lokale ose qendrore. Pra, siç

50 Fokus Grupi Veriu i Kosovës – raporti – Qendra Humane Mitrovicë

51 Raporti nga fokus grupi, deklarata e pjesëmarrësit në pyetjen: A veprojnë OJQ-të si kritikë të pushtetit – Qendra Humane Mitrovicë, janar 2022.

52 Vërejtje e autorit

53 Intervista me liderin civil – PD2

54 Intervista me liderin civil – PD2

ka arritur në përfundim të ilustruar një nga pjesëmarrësit e fokus grupit, “është shumë më fitimprurëse për organizatat joqeveritare të jenë shërbime të partive politike sesa kritikët e tyre.”⁵⁵

Nga ana tjetër, edhe pse në pakicë, ekziston një numër organizatash të shoqërisë civile që veprojnë si kritikë të mirëfilltë të përfaqësuesve politikë të serbëve të Kosovës, për t'i mbrojtur interesat publike, pavarësisht ndikimit apo represionit politik. Këto organizata përballen me forma të ndryshme të presionit, duke përfshirë fushatat e njollosjes publike (përmes komunikatave (kumtesave) të Listës Serbe⁵⁶), mohimin e qasjes në informacione publike, por edhe qasjen në fonde në shpërndarjen e të cilave vendimet merren nga bartësit e funksioneve publike nga radhët e opsionit dominues politik në komunitetin serb. Pasi që bëhet fjalë për faktorë pothuajse ekzistencialë, sepse shumica dërrmuese e OSHC-ve veprojnë si shoqata jofitimprurëse, ndikimi i praktikave të tilla në OSHC-të është i konsiderueshëm, madje edhe për ato organizata që mbijetojnë falë pikëpamjeve të kritikëve të pavarur. Kështu ndodh shpesh që këto organizata të përdorin “masa të padukshme” siç janë për shembull forma të ndryshme të autocensurës⁵⁸, korigjimi i fokusit programor drejt «temave më të sigurta» apo zbutja e kritikave publike ndaj pushtetit. Pra, praktikat aktuale janë të tilla që nëse organizatat e shoqërisë civile e kryejnë rolin e tyre shoqëror me integritetin e nevojshëm, që përfshin prioritizimin e interesave të qytetarëve përballë elitave politike, kjo ka një ndikim të fortë në aftësinë për të gjeneruar mbështetje (fonde, bashkëpunim me institucionet lokale,

etj.) e cila është e nevojshme për përmbushjen e misionëve të tyre. Një lloj paradoksi me të cilin ballafaqohen OSHC-të.

Raporti i përfaqësuesve politikë të komunitetit serb ndaj organizatave të shoqërisë civile përkufizohet nga vetë kjo natyrë e angazhimit të tyre. Ato OSHC që e kultivojnë një qëndrim kritik ndaj pushtetarëve shihen si një “e keqe e domosdoshme” ose siç e përshkroi një nga liderët politikë të opozitës në një intervistë për këtë hulumtim⁵⁹ si “barrë të padëshiruar shoqërore”. Trajtimi i veçantë i organizatave të tilla është injorimi i punës së tyre, kërkesave e tyre dhe përmbajtja nga bashkëpunimi. Në situatat kur kritikët që vijin nga organizata të tilla marrin më shumë vëmendje mediale dhe shoqërore, atëherë ndaj tyre përgjigjet me përpjekje për diskreditim publik të punës së tyre, shpifje mediale, komunikata të partive politike dhe të ngjashme.⁶⁰



Nga ana tjetër, ekziston një numër të madh organizatash që i kultivojnë lidhjet e ngushta me partitë politike në baza personale dhe shërbejnë si shërbimet e tyre, veçanërisht në programe që kërkojnë partneritet publiko-civil ose një kërkesë e tillë vjen nga donatorët. Organizatat e tilla mund të llogaritin jo vetëm në mbështetjen e pushtetarëve, por edhe në mbështetjen e drejtpërdrejtë financiare përmes programeve lokale zhvillimore.⁶¹

55 Citim fokus grupi Veriu i Kosovës – faqja e 3-të e Raportit – QHM

56 <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/srpska-lista-lokalni-samozvani-analiti-cari-ne-poseduju-elementarno-poznavanje>

57 <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/srpska-lista-sramno-sto-se-lincu-protiv-iva-na-todosijevica-prikljucila-i-srpska-nvo>

58 Intervista me liderin civil (sipas kërkesës pa cekjen e emrit) – PD 24, faqja 3

59 Intervista me liderin opozitar politik nga veriu i Kosovës – kërkesa për anonimitet.

60 ibid

61 Raporti nga fokus grupi Graçanica

Një tjetër specifike e rolit të sektorit civil në komunitetin serb në Kosovë, e cila në masë të madhe e dikton dinamikën dhe karakterin e marrëdhënieve me liderët politikë, është pjesëmarrja e liderëve civilë në pjesën e dialogut publik, i cili kërkon pjesëmarrjen e përfaqësuesve politikë/institucionalë të qytetarëve. Domethënë, një nga veçoritë themelore të strategjisë së komunikimit të Listës Serbe, opsionit kryesor politik të serbëve të Kosovës, është paraqitja ekskluzivisht në një mjedis rreptsisht të kontrolluar medial dhe publik dhe shmangia e debateve në të cilat prezantohet ana kritike, një qasje e tillë lë një boshllëk të madh në dialogun publik në shoqërinë kosovare. Ekziston një tendencë e dukshme që ky boshllëk, mungesa e përfaqësuesve të zgjedhur politikë të komunitetit serb, të plotësohet nga liderët dhe individët e shquar të shoqërisë civile, duke marrë kështu një rol shumë të përgjegjshëm në përfaqësimin e interesave të komunitetit serb. Në këtë mënyrë, liderët civilë kanë mundësi të diskutojnë për një gamë të gjerë çështjesh, ndonjëherë jashtëzakonisht komplekse teknikisht për të cilat nevojitet analiza e ekspertëve ose një mandat institucional. Në shumicën e rasteve, një ekspertizë e tillë nuk është në dispozicion të sektorit civil, dhe prandaj kështu jo vetëm që rrezikohet interesi i vërtetë i qytetarëve apo thellimi i animozitetit me përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të komunitetit serb, por edhe krijohet iluzioni i pluralizmit në dialogun social. Kjo “mimikri” e pluralizmit në dialogun shoqëror gjithsesi nuk e përmbush qëllimin e saj thelbësor, as nuk sjellë rezultate e dobi, të cilat i kishte prodhuar pjesëmarrja e përfaqësuesve të zgjedhur të komunitetit serb, pra të akterëve me mandat që të marrin vendime.

Kjo natyrisht se nuk do të thotë se liderët civil nuk duhet të marrin pjesë në dialogun shoqëror. Përkundrazi, ata kanë një rol të rëndësishëm në atë proces, duke vepruar

si faktor korigjues i pushtetit, por jo edhe si alternativë e tij.⁶²

Në pjesën kualitative (cilësore) të studimit, lideri/ja i/e një nga organizatat më të dalluara⁶³ që i përfaqësojnë interesat e komunitetit serb në Kosovë, tregoi për edhe një pasojë të këtij trendi. Sipas mendimit të tij/ të saj: *“në mungesë të opozitës politike si dhe të përgjegjësisë së përfaqësuesve politikë nga komuniteti serb, OSH-të që janë të orientuara ndaj kritikës publike, perceptohen si opozita politike ose si ata që pretendojnë të angazhohen politikisht. Në mungesë të dialogut (gjithëpërfshirës⁶⁴) shoqëror, çdo kritike, sado konstruktive qoftë ajo, përjetohet si sulm, kurse çdo aktivitet, i cili i prek temat e ndjeshme përjetohet si provokim i cili zbatohet me një agjendë konkrete.*

Andaj, si përfundim, brenda komunitetit serb në Kosovë ekziston një hendek i madh mes përfaqësuesve politikë dhe civilë të qytetarëve dhe interesave të tyre, që në disa situata kthehet në animozitete të hapura në të cilat pak ose as pak vëmendje i kushtohet interesit të qytetarëve. Në kontekstin shoqëror në të cilin të dy akterët i kryejnë detyrat e veta, e në të cilin komuniteti, interesat e të cilit i përfaqësojnë, përballet me probleme të panumërta në çdo fushë të jetës shoqëroro-politike, këto animozitete, përfundimisht janë të papërgjegjshme dhe e shkatërrojnë potencialin e tërësishëm të shoqërisë për të përparuar dhe për t'i avancuar kushtet në të cilat jetojnë qytetarët.

62 Ibid

63 Ibid

64 Vërejtja e autorit

Përfundimet

Profesioni “politikan” është diskredituar tërësisht. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se qytetarët e barazojnë profesionin “e politikanit” me modelet joetike të sjelljes. Më saktësisht, sfera e veprimtarisë politike perceptohet si një sistem vlerash në të cilin manipulimi me interesat e qytetarëve, manipulimi me të vërtetën, nepotizmi apo klientelizmi etj., janë dukuri tërësisht të zakonshme dhe të nënkuptuara. Format e tilla të sjelljes janë të rrënjësura deri në atë masë sa qytetarët i shohin si parakusht për t'u marrë me politike me sukses. Andaj, qytetarët nuk e bëjnë dallimin në mes të disa opsioneve politike brenda komunitetit serb në Kosovë, por, siç tregojnë në pjesën kualitative (cilësore) të hulumtimit, modelet e tilla të sjelljes ekzistojnë, në një formë pak a shumë të theksuar, në komunitetin serb që nga viti 1999 e deri sot. Prej këtu rrjedh edhe ndjenja mbizotëruese e qytetarëve se asgjë nuk po ndryshonte në planin politik për dekada të tëra, sepse të njëjtët njerëz janë merren me politikë, apo edhe kur ndodhin ndryshime të caktuara, elita e re politike i adopton shpejt modelet identike të sjelljes dhe të marrjes me politikë. Rezultati është gjendja aktuale në të cilën profesioni “i politikanit” në mjedisin folklorik perceptohet si një profesion “i pandershëm” dhe abstenimi nga veprimi politik shpesh paraqitet si një tipar/vlerë pozitive (e ndershme). Nuk është e nevojshme të theksohet se sa shkatërruese është kjo për potencialin demokratik të shoqërisë apo për perspektivat e përparimit të saj.

Diversiteti është i rrezikshëm. Një nga konkluzionet më mbresëlënëse nga hulumtimi, por edhe nga fokus grupet e mbajtura në pjesën kualitative (cilësore) të hulumtimit, është se të anketuarit, shumë prej të cilëve janë të suksesshëm profesionalisht dhe akademikisht, nuk kanë mundur të përmendin asnjë moment/ periudhë në

historinë politike të serbëve të Kosovës në të cilin/ cilën në shoqëri ekzistonte liria e vërtetë e të shprehurit publik e rrjedhimisht edhe pluralizmi në përfaqësimin politik të interesave të tyre. Natyrisht, disa të anketuar bënë dallime ndërmjet atmosferës së përgjithshme shoqërore në periudha të caktuara⁶⁵, por në thelb ata pajtohen se në disa dekada të fundit ka pasur gjithmonë presion të fortë shoqëror dhe politik ndaj atyre që mendonin ndryshe nga “partia në pushtet” në Beograd. Shkaku i kësaj dukurie, siç e kemi theksuar, është i rrënjësor në mosekzistimin e interesave të përkufizuara kombëtare të serbëve dhe komunitetit serb në politikë ndaj Kosovës dhe rrjedhimisht barazimin e tyre me interesat e partive politike në pushtet në Republikën e Serbisë. Në rrethana të tilla, partitë politike e emërojnë politikën e tyre si interes kombëtar dhe çdo kritikë ndaj një qasjeje të tillë apo mendimit të ndryshëm e shpallin si tradhti e interesave kombëtare. Sipas mendimit të të anketuarve, format e tilla të sjelljes, edhe pse të pranishme me dekada, kulmuan me paraqitjen e Listës Serbe, përkatësisht me ardhjen në pushtet të Partisë Përparimtare Serbe në Serbi. Me këtë ndryshim të praktikës së mbyqjes së pluralizmit politik në komunitetin serb, ato marrin karakterin e përpjekjes sistematike. Jotoleranca ndaj mendimit të ndryshëm sot, siç tregon hulumtimi, nuk ekziston vetëm në arenën politike, por është e kufizuar në mënyrë aktive në fusha të tjera të veprimit publik, mediave, nismave qytetare etj.

Keqpërdorimi i burimeve publike. Hulumtimi tregon se një numër i madh i qytetarëve konsideron se burimet publike janë të qasshme vetëm për një grup të ngushtë dhe të privilegjuar të njerëzve dhe se shpërndarja e tyre nuk përcaktohet nga parimet e drejta

⁶⁵ Ibid, citat – “më duket se ishte shumë më lehtë të kritikosh gjatë Qeverisë së (Zoran) Gjingjiqit.”

dhe procedurat e parashikueshme ligjore, por duke favorizuar bashkëvendimtarët politikë. Në rrethana të tilla, motivi mbizotërues i qytetarëve për t'u përfshirë në proceset politike është pikërisht qasja e tillë e lehtësuar në burime (fondet publike, punët në sektorin publik). Pra, përfshirja e qytetarëve në proceset politike nuk është motivuar me qëllimet e avancimit shoqëror përmes ndryshimeve apo pluralizmit të ideve, por pikërisht përkundrazi, me përfitim personal. Sigurisht që në këtë perceptim kanë ndikuar shumë përpjekjet e dukshme të mbyrtjes së pluralizmit politik dhe veprimit opozitar, të cilat shpërqendrojnë një numër të madh të qytetarëve nga angazhimi politik jashtë interesave të partisë në pushtet.

Simulimi i demokracisë. Marrëdhënia e liderëve të zgjedhur politikë dhe përgjegjësia e tyre ndaj interesave të qytetarëve është një temë tabu në shoqërinë serbe në Kosovë. Çdo kritikë publike, kërkesa për informata (transparencë), pra, kërkesa për llogaridhënie publike, për ta thënë më butë, shihet si një cenim i privilegjeve të politikanëve dhe pritet me dënimin publik të lodhur të bartësve të tyre dhe forma të tjera të presionit. Kjo çon më tej në njollosjen e tyre publike dhe madje edhe etiketimin e tyre si tradhtarë të interesave kombëtare. Praktikisht nuk ka debate publike në të cilat përfshihen interesat e ndryshme. Qasja proaktive e liderëve politikë dhe institucionalë drejt përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes është reduktuar në një plotësim të formës (detyrimeve ligjore). Qasja afirmative e politikanëve ndaj qytetarëve është e kufizuar ngushtë në procesin zgjedhor, në të cilin dominojnë floskulat populiste, njollosja agresive e kundërshtarëve dhe presionet e ndryshme e gjithnjë e më kreative ndaj votuesve. Pra, parë nga një kontekst më i gjerë, ekziston një përpjekje strukturore për të simuluar parimet dhe proceset demokratike. Një gjendje e tillë, edhe pse mori vrull pas ardhjes në pushtet të eksponentëve të Partisë Përparimtare Serbe, ekziston që nga viti 1999 (madje edhe më herët). Mjaft gjatë për t'u bërë modeli i

nënkuptuar i veprimit politik i cili njihet gjithnjë e më pak si i paligjshëm ose i jo-legjitim.

Autocensura si një modus operandi. Siç tregon hulumtimi, shoqëria civile që vepron brenda komunitetit serb në Kosovë në masë të madhe i shikon proceset politike nga këndvështrimi i vëzhguesit pasiv. Numri shumë i vogël i organizatave dhe individëve me integritetin e nevojshëm e ushtrojnë rolin e tyre të “rojtarit të interesit publik”⁶⁶ e akoma më pak arrijnë t'i rezistojnë presionit të përfaqësuesve politikë të komunitetit dhe ta ruajnë fokusin e nevojshëm programor ose ta shmangin autocensurën. Pikërisht është autocensurimi, jo vetëm i organizatave të shoqërisë civile, por edhe i akterëve të tjerë shoqërorë (mediat, përfaqësuesit e qytetarëve, etj.) është një nga pasojat kryesore të atmosferës së frikës që aktualisht mbizotëron në komunitetin serb në Kosovë. Kritika shoqërore që depërton në thelbin e problemit nuk është mjaft e shprehur, andaj duket se shoqëria në tërësi nuk ka potencial të mjaftueshëm për t'i sjellë ndryshimet e dëshiruara.

OO Ky është pikërisht përfundimi i përgjithshëm i hulumtimit.

Mungesa e pluralizmit politik dhe kulturës së angazhimit politik të qytetarëve në mjediset serbe në Kosovë ka arritur përmasa alarmante dhe është e pranishme deri në atë masë sa që ka ndikim të fuqishëm në potencialin e komunitetit për të luftuar për përmirësimin e kushteve dhe të perspektivës së jetesës në Kosovë. Aktualisht, interesat e komunitetit serb përfaqësohen nga një grupim politik që i nënshtron interesat e qytetarëve ndaj interesave të një prej opsioneve aktuale udhëheqëse politike në Serbi. Me kontroll të plotë të burimeve publike, me mbështetjen e Beogradit dhe të mediave kryesore nga Serbia, ky grupim politik po e mby

⁶⁶ Termi shumë i njohur në gjuhën angleze “watchdogs role” prim.aut.

sistematikisht çdo përpjekje për organizim të pavarur politik në komunitetin serb, pa zgjedhur metodat me të cilat arrihet kjo.

Si pasojë i presioneve të tilla, serbët e Kosovës janë absolutisht të frikësuar dhe të demotivuar në mënyra të ndryshme për të luftuar për interesat dhe qëllimet e tyre në arenën politike. Në vend të kësaj, ata janë të detyruar të jenë thjesht dëshmitarë të aferave të ndryshme korruptive, praktikave të nepotizmit dhe klientelizmit në shpërndarjen e burimeve publike që e nënshtrojnë besnikërinë partiake ndaj kriterëve të kualifikimit dhe arsimimit. Pasojat e një gjendjeje të tillë janë të shumëfishta, për shembull largimi në rritje i të rinjve nga Kosova në kërkim të punës, ose zvogëlimi i fuqisë së shoqërisë serbe në Kosovë për të identifikuar interesat e veta të vërteta dhe për t'i mbrojtur ato përmes angazhimit politik. Njërin nga përshkrimet më ilustruese të gjendjes së tillë e ka dhënë njëri prej të anketuarve në pjesën kualitative (cilësore) të hulumtimit i cili ka thënë: Nga terreni drejt Beogradit prej kohësh nuk ka asnjë nismë të rëndësishme⁶⁷, duke implikuar pasivitetin e plotë politik të serbëve të Kosovës.

⁶⁷ Goran Avramović, intervista



Rekomandimet

Pandësia politike, si një nga konkluzionet më mbresëlënëse të këtij hulumtimi, është një rrezik serioz për potencialin e arritjes së përparimit demokratik, por edhe social të komunitetit serb. Zgjidhja e këtij problemi kërkon mobilizim të përgjithshëm shoqëror dhe të gjithë akterët shoqërorë, përfshirë partitë politike, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, e bartin përgjegjësinë në këtë proces. Nevojitet një qasje holistike që do të merrte parasysh të gjitha shkaqet dhe manifestimet e vërteta të këtij problemi. Autorët e këtij raporti rekomandojnë se mediat dhe OSHC-të duhet t'i zgjerojnë fokuset e tyre programore në zbërthimin e perceptimit të dëmshëm se marrja me politikë është e rrezikshme dhe në kundërshtim me normat e etikës shoqërore. Për këtë qëllim, është e nevojshme:

OO Të promovohet angazhimi politik si mënyrë efektive për përmbushjen e qëllimeve dhe të nevojave të komunitetit. Ideja se marrja me politikë nuk është domosdoshmërisht vetëm angazhim partiak, por edhe llojllojshmëri e aktivizmit lokal dhe shoqëror, i cili i kontribuon jetës më të mirë të individëve dhe të komunitetit, është mesazhi thelbësor i cili duhet t'i përçohet qytetarëve.

OO Promovimi i pluralizmit politik përmes dialogut të hapur dhe gjithëpërfshirës shoqëror, në të cilin janë prezantuar interesat dhe pikëpamjet e ndryshme.

OO Të motivohen të rinjtë përmes fushatave të synuara ndërgjegjësuese që të marrin pjesë aktivisht në jetën shoqërore të komunitetit.

OO Të mbrohet sistematikisht dhe me solidaritet të nevojshëm parimi i lirisë së shprehjes publike në rastet e fushatave të njollosjes publike, kërcënimeve ndaj individëve apo formave të tjera të presionit

ndaj pjesëmarrësve në dialogun publik.

OO Të fuqizohen strukturalisht kapacitetet e brendshme të OSHC-ve dhe mediave në luftë kundër autocensurës.

OO Pjesëmarrja aktive e mediave dhe të OSHC-ve në monitorimin e proceseve zgjedhore në nivelin lokal dhe parlamentar. Barazia e kushteve zgjedhore për të gjithë akterët, liria e zgjedhjes, fshehtësia e votës, vetëm janë disa nga elementet e procesit të lirë dhe demokratik zgjedhor të cilit duhet t'i kushtohet vëmendja.

OO Të rritet aftësia e përgjithshme shoqërore për të luftuar kundër korrupsionit dhe kljentalizimit, sidomos në manifestimet e saj më shkatërruese siç janë punësimi i të rinjve dhe të ngjashme, përmes programeve të synuara të fuqizimit të rezistencës qytetare⁶⁸.

OOO

Partitë politike dhe përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kosovë duhet të përpiqen të arrijnë ndryshime thelbësore në shoqëri, përmes promovimit të përgjegjesisë në ushtrimin e funksioneve publike. Përveç kësaj, është i domosdoshëm /e domosdoshme:

OO Që bartësit e funksioneve politike dhe publike në komunitetin serb t'i inkurajojnë dhe t'i aplikojnë, përmes qasjes afirmative, mekanizmat ekzistuese ligjore dhe praktikat e mira të pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike dhe në procesin e vendimmarrjes.

OO Inkurajimi dhe qasja aktive ndaj fuqizimit të partneritetit publik (qytetarët dhe bartësit e funksioneve politike dhe institucionale) për

68 Përkthim i lire i termit - Civic Resilience. Prim.aut.

t'i arritur qëllimet e përgjegjshme shoqërore.

OO Subjektet politike që veprojnë në opozitë duhet t'i shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat e mbrojtjes së lirisë së bashkimit politik dhe të mbrojtjes nga fushatat e njollosjes publike të anëtarëve të tyre dhe akterëve të tjerë shoqërorë.

OO Organizatat politike duhet ta inkurajojnë dhe të punojnë në mënyrë aktive në përfshirjen e të rinjve në jetën politike të komunitetit serb.

OO Pjesëmarrja aktive e përfaqësuesve politikë në dialogun publik dhe promovimi i parimit të tolerancës ndaj mendimit të ndryshëm.



Iniciativa OPEN është përkrahur nga:



KFOS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo